



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës



Autoritet za Konkurenciju Republike Kosovo - the Competition Authority of the Republic of Kosovo

Vendimi Nr. 53/2022

Data: 12.12.2022

Duke u bazuar në nenet 4,11,13,15,16,17,18,26,27 dhe 55 par 1.5 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrotjtjen e Konkurrencës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, në mbledhjen e datës 12.12.2022, mori këtë:

VENDIM

I. LEJOHET Përqendrimi i ndërmarrjeve: DANX Group A/S (Pala 1) dhe ILS Spółka Z Ograniczona Odpowiedzialnoścía (Pala 2), për krijimin e një ndërmarrje të Re të përbashkët me funksion të plotë, që është bazuar në Marrëveshje të lidhur më datë 14 Shtator 2022.

Pala 1. DANX Group A/S është shoqëri publike, e organizuar sipas ligjeve të Danimarkës, e regjistruar në Vejleåvej 9, DK-2635 Ishoj - Danska, me numër regjistrimi 28665210, DANX është kompani logjistike e specializuar për shpërndarje gjatë natës të pjesëve të këmbimit ndër të tjera pjesë të IT, Makinave, pjesë bujqësore dhe pjesë elektro shtëpiake të mëdha.

Pala 2. ILS, Spółka Z Ograniczona Odpowiedzialnoścía shoqëri private Polake me përgjegjësi të kufizuar, me zyrën e saj të regjistruar në adresën Swobodnia 35, 05-180 Zakroczym - Poloni, numri i regjistrimit 146368675, ILS është kompani logjistike që ofron shërbime dhe zgjedhje të dedikuara në lidhje me magazinimin e mallrave të transportit vendas dhe ndërkombëtarë.

Shoqëri e Re Sipërmarrje e Përbashkët (SP), me emrin e biznesit DANXILS sp. z.o.o, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjeve të Polonisë, Aktiviteti i Shoqërisë së Re, do të operojë në territorin e Republikës së Polonisë dhe do të ofroj shërbime të veçanta: shpërndarje gjatë natës, PUDO zgjedhja (merr - le) FSL (Vendndodhja për stoqe e para - të depo magazinimit). Aktualisht nuk ka plane që **“Shoqëria e Re”** e propozuar të jetë aktive, apo të ushtrojë aktivitet në Kosovë

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 100.00 € me shkronja (njëqind euro) dhe për vendimin për lejim të Përqendrimit, pagesë në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja, (tre mijë) Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës më datë 04.11.2022 ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 321/22-01/H, lidhur me njoftimin për Përqendrim të ndërmarrjeve DANX Group A/S dhe ILS Spółka Z Ograniczona Odpowiedzialnoścía, për krijimin e

Autoriteti i Konkurrencës

Adresa: Ish Banka e Lubjanës – Rr. Migjeni, Prishtinë, Katë i VI, zyra nr.1 Tel: +381 /0/ 38 200 109 29

një Shoqërie të Re me përgjegjësi të kufizuar sipas ligjit të Polonisë, që operon nën emrin e biznesit DANXILS sp. z.o.o (Shoqëri e Re).

Njoftimi për Përqendrim, është i bazuar në Marrëveshje të lidhur, më datë 14 Shtator 2022, për krijimin e një ndërmarrje të Re të përbashkët me funksion të plotë, ndërmjet ndërmarrjeve DANX Group dhe ILS, në të cilën do të zotëronin nga 50% të aksioneve.

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës/dokumentacioni;
2. Vërtetimi për kërkesën e dorëzuar me datë 14.11.2022;
3. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKK-së me datë 11.11.2022;
4. Kërkesa për përqendrim është bazuar në marrëveshjen e datës 14 Shtator 2022, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen, për krijimin e **Shoqërisë së Re**. DANX dhe ILS do të zotëronin nga 50% të aksioneve në Sipërmarrje e Përbashkët (SP), me emrin e biznesit DANXILS sp. z.o.o.

Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit:

Sipas nenit 13 të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumën 20,000,000.00 (me shkronja: *njëzetë milion Euro*);
- b) Qarkullimi në tregun e brendshëm, kalon shumën 1,000,000.00 (me shkronja: *një milion Euro*);
- c) Qarkullimi i dy palëve në tregun e brendshëm, kalon shumën 3,000.000.00 (me shkronja: *tre milion Euro*);
- d) Ndërmarrjet DANX dhe ILS, synojnë të krijojnë një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, që do të zotëronin nga 50% të aksioneve dhe të drejtat e votës në (Shoqërinë e Re) që operon nën emrin e biznesit DANXILS sp. z.o.o;
- e) Kontrata e Shitblerjes ndërmjet palëve, datë 14 Shtator 2022.

Vlerësimi i Konkurrencës:

Tregu i produktit - pjesët të makinave, elektro shtëpiake, bujqësore, bateri dhe të IT-së, ka të bëjë më ofrimin e shërbimeve të veçanta siç janë: shërbimet e brendshme shpërndarje/ndërkombëtare, transporti ajror, tokësor dhe detar si dhe shërbime gjatë natës, PUDO zgjedhja (merr - le) FSL (Vendndodhja për stoqet e para – të depo magazinimit).

Tregu gjeografik - do të mbetet nivel kombëtarë, Poloni, Letoni si dhe vendet e Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE), ndërsa si treg kombëtar do të përcaktohet territori i Republikës së Kosovës.

Vlerësimi i pjesëve të tregut

DANX, operon në territorin e Suedisë, Norvegjisë, Danimarkës, Finlandës dhe shtete baltike. AXEL dhe DANX nuk janë prezent në tregun përkatës, nuk kanë aktivitete apo kanë shoqëri apo filiale të regjistruar në Republikën e Kosovës. AXEL ka arritur qarkullim në Kosovë përmes kompanisë Nissens, e cila nuk është aktive në tregun e logjistikës në Kosovë, po ashtu ILS nuk është aktive në Republikën e Kosovës, kjo

operon në territorin e Polonisë, qarkullimi në Kosovë u realizua nga Inter Cars Bulgaria Ltd një filial bullgar Inter Cars S.A.

Tregjet e Prekura

Transaksioni nuk krijon tregje të prekura, pasi që Kosova nuk është pjesë e Bashkimit Evropian, po ashtu palët në përqendrim nuk janë në treg të njëjtë të produktit, që do të thotë në mes tyre nuk ka marrëveshje vertikale, ndërsa tregu përkatës gjeografik është vetëm tregu i Polonisë dhe EEA, Pjesëmarrësit: 1 dhe 2 nuk janë aktiv në Republikën e Kosovës pasi që nuk ka shoqëri apo filiale në Kosovë, strukturën e tregut, transaksioni nuk do të shkaktoj çrregullim të konkurrencës, apo të ndikoj në krijimin apo forcim të pozitës dominues në treg.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Polonisë, kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se Palët operojn vetëm me shitje përmes grupit që i përkasin, shitje bëhen përmes Nissens dhe Inter Cars Bulgaria Ltd. Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk mund të ketë efekt negativ në Kosovë, se palët nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit. Ndërmarrjet e përfshira në përqendrim nuk do të kenë efekt negativ në tregun kosovar, e rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare

Besim Stublla
Anëtar



Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arhiva